



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

15-04-2013

Organit. Reg. Broj	Numri/Broj	Datojot. Prilloj	Vlera Vendiqes
	01-013/320		

Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti/na

Ne bazë të nenit 17 pika f) nenit 40.2 pika 1 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta zyrtare nr 28/2008, nenit 6 të Ligjit me nr 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr 03/L 087. dhe nenit 78 pika 1 të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr 013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 12.04.2013, aprovon këtë:

V E N D I M  
PËR THEMELIMIN E NDËRMARRJES PUBLIKE KOMUNALE

Neni 1

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Vitisë, APROVON Vendimin për themelimin e Ndërmarrjes Publike Komunale për menaxhimin e mbeturinave në gjithë territorin e Komunës së Vitisë.

Neni 2

Ndërmarrja Publike Komunale për menaxhimin e mbeturinave do të jetë Shoqëri Aksionare.

Neni 3

Me këtë vendim caktohet emri i NPK "NATYRA" në Viti dhe Emblemës së Ndërmarrjes Publike Komunale.

Neni 4

Me këtë vendim garantohen kriteret për themelimin e Ndërmarrjes Publike Komunale që janë të përcaktuara në nenin 5 të Rregullores me nr 02/2013 mbi kriteret për krijimin e Ndërmarrjeve Publike Komunale.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë e Komunës së Vitisë.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Drejtorisë për Shërbime Publike
2. Arkivit



KRYESUESI I KUVENDIT  
Skenderbe Hebibi

*Skenderbe Hebibi*